URDHËR
Nr. 291, datë 27.12.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të pikës 2 të kreut I, të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet ose transformohet, në procedurën e shitjes", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zëvendësministrit të Financave dhe Ekonomisë, z. Endrit Yzeiraj, për ndjekjen e komunikimeve me institucionet qendrore dhe organet e vetëqeverisjes vendore, për prononcim privatizimi nga ana e tyre për pasuritë e ndërmarrjeve apo institucioneve që kanë në varësi administrative këto institucione, dhe sipas rastit, ngritjen e komisionit të verifikimit faktik të objektit.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, z. Endrit Yzeiraj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Ervin Mete